



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 949/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Muharrem Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Gjilan, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), në seancën e panelit të mbajtur me 21.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Gjilan,

Arsyetim

PZAP-i, me datën 20.11.2013 ka pranuar një ankesë përmes postës, nga subjekti politik PDK, në të cilën thekson se është bërë vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike nga ana e QNR-së sepse raportet e pranuar nga KQZ në Gjilan lidhur me rezultatet zgjedhore kanë përmbajtur vërejtje dhe kanë qenë në karantinë, dhe të njëjtat nuk janë trajtuar si të tilla. Sipas parashtruesit të ankesës votat në këto kuti është dashur të shpallen si të pavlefshme, ndërsa KQZ rezultatet përfundimtare i ka shpallur pothuaj se të njëjta me ato preliminare përkundër parregullsive të evidentuara.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur raportet nga qendra e vendvotimeve të cilat kontestohen në Gjilan, dhe i propozon PZAP-it që të aprovoj ankesën e subjektit politik PDK dega në Gjilan si të bazuar dhe të anulohet pjesërisht vendimi i KQZ-së për shpalljen e rezultateve zgjedhore për kryetar komune të Gjilanit, duke urdhëruar QNR-në që të rinumëroj votat e kontestuar në formularët e paraqitura si provë.

PZAP-i ka shqyrtuar, provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç e në lidhshmërinë si dhe duke u bazuar në rezultatin e tërësishëm të provave të administruara ka gjetur se:


Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e pa bazuar pasi që në bazë të shqyrtimit të materialit zgjedhore të bashkangjitur si provë nga pala ankuese PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë dhe se janë të pabazuara pasi që në asnjë moment nuk është arritur të vërtetohen ato për të cilat pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj një pretendim i tillë i është i pabazë dhe i pa argumentuar mirë në prova dhe në dëshmi bindëse, prandaj PZAP-i duke u bazuar nenin 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 949/2013 më datën 21.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë juridike: *PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*